



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 81, datë 30.08.2010

PËR

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN “PËR EKSPERTËT
KONTABËL TË AUTORIZUAR TË SHOQËRIVE TË SIGURIMIT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, Ligjit nr. 9267, datë 29.07. 2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime e risigurime” dhe Rregullores “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit”, me propozim të Drejtorisë së Inspektimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për ekspertët kontabël të autorizuar të shoqërive të sigurimit” miratuar me vendimin e Bordit nr. 10, datë 17.12.2007, si më poshtë:
 - a) Në pikën 2.3 të nenit 2, paragrafi i parë, fjalia “*Letrën e angazhimit të paraqitur nga shoqëria e ekspertëve kontabël*”, zëvendësohet me fjalinë “*Letrën e angazhimit për aktivitetin e shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit në Shqipëri, si dhe për aktivitetin e konsoliduar të shoqërisë së sigurimit dhe risigurimit*”;
 - b) Në pikën 2.3 të nenit 2, paragrafi i dytë pas fjalëve “*në auditimin e subjekteve*”, shtohet fjala “*financiare*”;
 - c) Në pikën 8.1 të nenit 8, pas fjalës “*...në vazhdim, hiqet shprehja “nga momenti i miratimit të saj*”;
 - d) Pika 8.3 e nenit 8, ndryshohet si më poshtë “*Shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet një kopje të raporteve të Shoqërisë së Ekspertëve kontabël të autorizuar së bashku me “Letrën për drejtimin” (Letra e menaxhimit) që Shoqëria e Ekspertëve kontabël të autorizuar përgatit për drejtuesit e lartë të shoqërisë së sigurimit, si edhe vlerësimet e komitetit të kontrollit të brendshëm, të përgatitura sipas kërkesave të neneve 5, 6 dhe 7 të kësaj rregulloreje apo çdo raporti tjetër të kërkuar, jo më vonë se afatet e përcaktuara në nenin 1 të Ligjit nr. 9685, datë 26.2.2007, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004, Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime e risigurime*”;
 - e) Pika 8.2 e nenit 8, shfuqizohet.
 - f) Kudo në rregullore emërtesa “*ekspert kontabël i autorizuar*” zëvendësohet me emërtesën “*Ekspert kontabël i regjistruar*”.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI